



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2020:021229

Datë: 24.02.2021

Numri i dokumentit: 01538725

P.nr.129/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bahrije Smakolli, në çështjen juridiko-penale kundër të pandehurve Rr.S. nga fshati M.në Vushtrri, të pandehurit Y.B. nga fshati S. E. Vushtrri për shkak të veprës penale Lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par 1 pika 1.3 të KPRK-së e lidhur me nenin 31 dhe të pandehurës A.P.-G. nga Vushtrria Rr. "F. R.", për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së të KPPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.559/15 e datës 04.02.2020 (2019:0120180), pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës 08.02.2020, në praninë e Prokurores së shtetit Daniella Batkoviq, të pandehurve Rr.S. dhe Y.B. dhe avokates mbrojtëse të të pandehurit Y.B. av. Fatmire Braha pas shpalljes së aktgjykimit me datë 08.02.2021, me datë **24.02.2020** përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I. I PANDEHURI I PARË: Rr. S. nga i ati R. e ëma Sh. e gjinisë H. i lindur më 23.05.1985 në M. Komuna e Vushtrrisë, i martuar, nuk ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, punon kohë pas kohe, me numër personal ... më parë i pa gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. I PANDEHURI I DYTË: Y.B. nga i ati E. e ëma N. e gjinisë B. i lindur më ... në fshatin S. E./Vushtrri, i martuar, prind i tre (3) fëmijëve, ka të kryer Fakultetin e Xehtarisë dhe Masterin, i gjendjes së mesme ekonomike, punon kohë pas kohe, me numër personal ... më parë i pa gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

SEPSE: Ekziston dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit Rr. S. Y. B. dhe tani të ndjerit V. B. me datën 27.04.2015 rreth orës 14:14 minuta, në fshatin S. të E.-Vushtrri, në bashkëkryerjen i shkaktojnë lëndime të rënda trupore të dëmtuarit B. G. ashtu që fillimisht i ndjeri V. B. posa arrin me kamionin e tij përballë shtëpisë së tij ndalon kamionin dhe i bllokon rrugën të dëmtuarit, i cili ishte me automjetin e tipit "A. A6", e ku menjëherë i njëjti merr gyp te hekurit te vinçit-56cm, ku i ofrohet të dëmtuarit që i njëjti të del jashtë e ku pas disa fjalëve fillon ta godas me gyp ne pjesën e gjoksit, fytyrës dhe shpinës pastaj goditjes i bashkëngjiten edhe dy të pandehurit Y. B. dhe Rr. S. ku vazhdojnë të godasin të dëmtuarin me grushte dhe shqelma në pjesën e trupit, ku i shkaktojnë frakturë te hundës, dëmtime këto që bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore.

- **Me këtë kanë kryer veprën penale Lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par 1 pika 1.3 të KPRK-së, e lidhur me nenin 31 të KPRK-së**

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 8, 17, 21, 31, 41, 42, 49, 50, 51, 73,74 dhe nenit 189 të KPRK-së si dhe nenit 365, 450, 461 të KPPK-së, i

G J Y K O N

TE PANDEHURIT TË PARË Rr. S. i shqipton **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej 2 vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri gjatë kohës së verifikimit në kohëzgjatje prej tre (3) vite nuk kryen vepër tjetër penale.

TE PANDEHURIT TË DYTË Y.B.i shqipton **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej 1 vit e 6 muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri gjatë kohës së verifikimit në kohëzgjatje prej dy (2) vite nuk kryen vepër tjetër penale.

Pala e dëmtuar B. G. ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale.

DETYROHEN të pandehurit secili veç e veç që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajnë shumën prej tridhjetë euro (30€).

DETYROHEN të pandehurit veç e veç që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej pesëdhjetë euro (50€).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Ndaj të pandehurës A. P. G. gjykata me datë 24.08.2020 ka marrë aktvendim P.nr.129/2020 për aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimi me datë 11.08.2020 sa i përket dispozitivit II të aktakuzës.

A r s y e t i m

I. Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur PP.II.nr.126/2013 e datës PP.II.nr.559/15 e datës 04.02.2020 (2019:0120180), ndaj të pandehurve Rr. S. nga fshati M. në Vushtrri, të pandehurit Y. B. nga fshati S. E.-Vushtrri për shkak të veprës penale Lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par 1 pika 1.3 të KPRK-së lidhur me nenin 31 të KPRK dhe të pandehurës A. P.-G. nga Vushtrria Rr. “F. R.”, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së të KPPK-së, për të cilën gjykata ka marrë aktvendim P.nr.129/2020 për aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimi me datë 11.08.2020 sa i përket dispozitivit II të aktakuzës.

Gjyqtari i vetëm gjykues me datë 02.12.2020 ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në këtë seancë të pandehurit Rr. S. dhe Y. B. nuk e kanë pranuar fajësinë në të cilën seancë pas fjalës hyrëse janë administruar provat personale dhe materiale. Seanca e shqyrtimit gjyqësor ka vazhduar me datë 24.12.2020, 19.01.2021 dhe 08.02.2021 në të cilat seancë janë administruar provat plotësuese, është marrë në pyetje i pandehuri dhe pas fjalës përfundimtare të palëve është shpallur edhe aktgjykimi.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor

Prokurori i shtetit gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor në fjalën hyrëse ka deklaruar se, gjatë shqyrtimit gjyqësor do të provohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet, në bazë të dëshmisë së të dëmtuarit – dëshmitarit B. G. dhe në bazë të shkresave të lëndës, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, më shqyrtimin gjyqësor është provuar se të pandehurit Rr.S. dhe Y. B. kanë kryer veprën penale e cila iu vihet në barrë në bazë të akuzës, dhe atë në bazë të deklaratës së të dëmtuarit B. G. raporteve mjekësore, ekspertizës mjeko – ligjore si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës. I dëmtuari B.G.në deklaratën e dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se të pandehurin e kanë rrahur në pjesë të ndryshme te trupit me ç ‘rast i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore se i janë shkaktuar lëndime të rënda trupore vërteton edhe ekspertiza ligjore raportet mjekësore dhe foto dokumentacioni. Nga ana tjetër të pandehurit nuk e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohen, i pandehuri Rr. S. ka deklaruar se është munduar që vetëm ti ndaje të dëmtuarin B. G. dhe të ndjerin V. B. i pandehuri Y.B. deklaroi se nuk ka marrë pjesë në këtë ngjarje deri në momentin që ka qenë i detyruar ta shoqërojë në spital tani të ndjerin V. B. deklaratat e tyre janë në kundërshtim në tërësi me deklaratën e të dëmtuarit. Gjykatës i ka propozuar që ta marrë me mirëbesim deklaratën e të dëmtuarit – dëshmitarit B. G. i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka identifikuar të pandehurit si sulmues ndaj tij. Nga deklarata e J. B. e cila deklaratë përputhet me deklaratën e të pandehurve prokuroria vlerëson se gjykata duhet të mos ia falë besimin, i pandehuri Rr.S. në këtë çështje penale ka pësuar lëndime të lehta trupore të cilat i ka shkaktuar A. G. bashkëshortja e të dëmtuarit B. G. me qëllim që të mbrojtë bashkëshortin e vet nga sulmuesit, në bazë të provave shihet se i njëjti i pandehur ka qenë në vendin e ngjarjes, nga foto dokumentacioni vërtetohet se në mes tjerash në vendin e ngjarjes janë gjetur edhe dy shkopinje të metalit gjë që na tregon se ka pasur më tepër sulmues, është karakteristike e këtij rasti se nuk kemi mundur ta dëgjojmë tani të ndjerin V. B. prokuroria konsideron se deklarata e të dëmtuarit B. G. ka qenë e mjaftueshme dhe e vërtetuar por do të ishte edhe më tutje e sqaruar nëse do të ishte dëgjuar edhe deklarata e A. P. të cilën e kemi përmendur të fjala hyrëse por nuk e kemi propozuar të procedura e plotësimit të provave, nga të cekurat si më larte prokuroria konsideron se aktakuza është e bazuar dhe i propozon gjykatës që të pandehurit ti dënoj dhe ti shpallë fajtor sipas ligjit.

I pandehuri i pare në fjalën hyrëse të shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e ndjen veten të pafajshëm dhe se vetëm ka qëlluar aty dhe qëllimi i tij ka qenë me i nda, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e ndjen veten të pafajshëm.

Avokatja mbrojtëse e të pandehurit të dytë në fjalën hyrëse ka deklaruar pas administrimit të provave të shqyrtimit gjyqësor do të vërtetohet pa fajësi e të mbrojturit të saj dhe atë duke u mbështetur te raporti i oficerit që është në shkresat e lëndës të datës 27.04.2015 ku cekën emrat e personave të dyshuar të cilët ishin të përfshirë në rrahje ku në mesin e këtyre personave askund nuk është i mbrojturi im, gjithashtu i mbrojturi im në polici është marrë në pyetje në cilësi të dëshmitarit dhe atë në deklaratën e dhënë me datën 17.04.2015 por edhe e nga provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës respektivisht deklaratat e të pandehurve të tjerë dhe të dëmtuarit askund nuk përmendet i mbrojturi im, sipas deklaramit të të mbrojturit tim që nga fillimi i kësaj procedure i njëjti atë ditë ka shkuar në vendin e ngjarjes pasi që ka dëgjuar ambulancën se mos ka shkel ndonjë automjet ndonjë fëmijë të tyre pasi që rrugën kryesore-magjistrale e kanë 100 metra afër shtëpisë dhe kur ka mbërritur në vendin e ngjarjes ka pa një turmë të njerëzve dhe pas fjalëve që i ka thënë baba i tani të ndjerit V. që ta shoqëron djalin e tij deri në spital, i njëjti e ka shoqëruar V. B.tani të ndjerin në spital, pasi që siç ka deklaruar tani edhe i mbrojturi im, babai i të ndjerit i ka pasur të lënduara dy këmbët dhe nuk lidhet me këtë rast, andaj ne konsiderojmë se pas administrimit të provave do të vërtetohet pafajësia e të mbrojturit tim. Ndërsa në fjalën

përfundimtare ka deklaruar se fillimisht i mbrojturi im Y.B. në Statcionin Policor në Vushtrri me datën 14.04.2015 është marrë në pyetje ne cilësi të dëshmitarit, dhe fotografitë që iu kanë bërë të dyshuarve, në vendin e ngjarjes nga njësia e forenzikes data e fotografive është 27.04.2015 (fotoalbumi që gjendet në shkresat e lëndës askund në këto foto nuk është i mbrojturi im Y.B. por gabimisht në foton nr 25 është shënuar Y.B. e që është vërtetuar se ky është i ndjeri V. B. e jo i mbrojturi im Y. B. e qe konsideroj se pikërisht nga ky gabim në foto ka hyrë si i dyshuar i mbrojturi im në këtë rast. Nga dëshmia e dëshmitarit J. B. në shqyrtim gjyqësor të datës 19.01.2020 ka deklaruar se Y. B. nuk ka qenë kur ka ndodhur rrahja në mes të V. B. Rr. dhe A. Prandaj nga të lartcekurat konsideroj se prokuroria me asnjë provë relevante nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar ekzistimin e veprës penale Lendim i rende trupor nga neni 189 par 1 pika 1.3 të KPRK-së.

I pandehuri i dytë Y.B. në fjalën hyrëse ka deklaruar se e mbështete në tërësi fjalën e avokates mbrojtëse dhe nuk kam asgjë për të shtuar. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën e avokates mbrojtëse.

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, më vëmendje të plotë dhe me përkushtim profesional, dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe faktet në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të tij, në vazhdim janë të shtjelluara provat e administruara, përfshirë:

Provat personale

- Dëgjimin e të dëmtuarit B. G. në cilësinë e dëshmitarit, i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 02.12.2020, ka deklaruar se gjate kësaj dite me dt 27.04.2015 ai ka qenë duke lëvizur me makinën e tij “A. A6” në fshatin S. në magjistralen Prishtinë-Vushtrri së bashku me të ka qene edhe gruaja e tij A.veturën e ka ndalur kur një kamion i cili kishte sinjalizuar me treguesin e majtë për tu kthyer në anën e majtë të rrugës nga maxhistranja, edhe pse kamioni ka dhënë sinjal i njëjti nuk është kthyer e ka ndalur kamionin në rrugë. Vozitësi i kamionit me një shufër të metalit i është ofruar te dritarja anësore e veturës në pjesën e shoferit dhe fillimisht ka filluar me shajtë dhe me fyer, dhe pasi që e ka mbyllur dyert automatike e ka hapur dritaren 10 cm dhe i është prezantuar se kush është duke i treguar se është me bashkëshorten e ti, dhe se e njëjta është e sëmurë pasi që ka qenë duke u kthyer nga spitali, por i njëjti ka vazhduar ta ofendojë dhe ta fyer dhe i është vërsulur drejtë dritares por nuk e ka goditur, i njëjti i ka thënë se me të dal nga Prishtina ka dashur ta tejkalojë të dëmtuarin por i njëjti e ka rritur shpejtësinë, dhe kjo nuk i kujtohet të dëmtuarit dhe nga i njëjti ka kërkuar ta lirojë rrugën. Më pas i njëjti person i shoqëruar edhe me persona tjerë që kanë pasur në dorë shufra metali i janë afruar veturës së tij dhe më pas ka vendosur me dal nga vetura së bashku me bashkëshorten A.me qëllim që të largohen nga aty dhe personi në fjalë e ka kapur për këmishe afër fyti e ka ngritur dorën me goditur me shufrën e metalit dhe më pas kanë ardhur edhe personat tjerë dhe më pas i dëmtuari së bashku me bashkëshorten kanë filluar të vetëmbrohen, personat të cilët e kanë sulmuar nuk i ka njohur më parë deri sa ka ardhur autobusi i policisë nga Vushtrria në drejtim të Prishtinës dhe policët kanë ndërhyrë për me i ndarë. Për të pandehurit ka deklaruar se i njeh dhe i janë kujtuar në gjykatë por edhe në polici, i pandehur i parë Rr. S. i kujtohet mirë që e ka sulmuar ditën kritike po ashtu i pandehuri i dytë Y. B. e ka sulmuar ditën kritike, i pandehuri i parë e ka goditur me shufër metalike ndërsa i pandehuri i dytë me shqelma në fytyrë, dhe nga këto goditje ka pësuar dëmtim

të rëndë trupor dhe më pas ka ardhur ambulanca. Në aspektin tradicional janë pajtuar familjet në mes vete.

- Dëgjimin e të dëshmitarit Y.B. i cili në seancën e vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor të datës 19.01.2021, ka deklaruar se me datë 27.04.2015 rrethores 14:14 ka qenë larg vendit të ngjarjes dikund 100 metra, dhe ka qenë me një klient dhe e ka parë që është ndalur autobusi i cili ka pasur polic dhe i është ofruar vendit të ngjarjes dhe ka pa V. B.tani të ndjerë duke u rrahur me të dëmtuarin dhe pasi që policia është ofruar vendit të ngjarjes nuk ka lejuar askënd të afrohet, i njëjti ka deklaruar se në vendin e ngjarjes ka arritur pothuajse në përfundim të rrahjes, ka arritur në vendin e ngjarjes i pandehuri Rr. ka qenë duke biseduar me vëllain dhe e ka pa që gruaja e të dëmtuarit A. e ka goditur me shufër metalike, më pas ka ardhur ambulanca dhe Y.B. ka ardhë me papuçe dhe vëllai im i ka thënë mos e le V. vetëm dhe shoqëroje deri në Vushtrri, i njëjti ka deklaruar se Rrahimin e ka pa duke i ndarë V. B. tani i ndjerë me të dëmtuarin.

- Marrje në pyetje të pandehurit të parë i cili ne seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 19.01.2021 ka deklaruar se me datë 27.04.2015 rreth orës 14:14 ka qenë i ulur duke biseduar me prindin e tani të ndjerit V. B. dhe e ka pa kamionin e V.i cili ka qenë i ndalur dhe e ka pa se i njëjti ka filluar të rrahet me të dëmtuarin B. G. dhe më pas i njëjti ka shkuar për ti ndarë dhe më pas e ka goditur bashkëshortja e të dëmtuarit duke menduar se ja ka sulmuar burrin dhe e ka goditur në krah, i njëjti ka deklaruar se i pandehuri i dytë Y.B. nuk ka qenë në vendin e ngjarjes dhe më pas e kanë marrë policia dhe i njëjti ka dhënë deklaratë në polici.

- Marrje në pyetje të pandehurit të parë i cili ne seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 19.01.2021 ka deklaruar se me datë 27.04.2015 ka pasur ditëlindjen vajza e ti, dhe më pas ka parë një grumbull të njerëzve dhe fillimisht ka menduar se i ka ndodhur diçka vajzës së tij dhe më pas e ka parë ambulanten e bardhë i cili barte policët dhe kontakti i tij i parë ka qenë me babain e të ndjerit V. B. M. i cili ka kërkuar ta shoqërojë të ndjerin deri në ambulancë për arsye se prindi i të ndjerit V. B.i ka pasur këmbët e thyera nga punët bujqësore, dhe e ka parë të pandehurin e parë duke biseduar dhe i njëjti ka deklaruar se ka dhënë deklaratë në polici me datë 11.01.2019 dhe ka kërkuar nga policia të mos e përfshijë në këtë rast sepse i njëjti vetëm e ka shoqëruar tani të ndjerin V. B. në ambulancë dhe nuk ka qenë në vendin e ngjarjes kur ka ndodhur rasti.

Provat materiale

- Raporti policor i dt. 27.04.2015 ku konstatohet se ka ndodhur një rrahje mes disa personave V. B. B. G. Rr. S. A. P.-G. dhe Y.B. ku Policia e Kosoves gjatë shikimit të vendit të ngjarjes kanë gjetur një gyp metali dorëz e Vinçit të automjeteve i gjatësisë 54 cm dhe një gyp metalik katror 2x2 i gjatësisë 59 cm.

- Raporti i oficerit i dt. 27.04.2015 përshkrimi i rastit se si ka ndodhur ngjarja ne ditën kritike, mjetet që janë përdorur, trajtimi i të dëmtuarit, si dhe njoftimi se në vendin e ngjarjes ka dalur njëjti i hetuesisë dhe forenzikes dhe mjetet që janë përdorur në këtë rrahje janë konfiskuar.

- Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes ku është përshkruar vendi i ngjarjes në fshatin S. në rrugën Vushtrri – Prishtinë, në rrugë në anën e djathtë janë vërejtur shenjat e frenimit të kamionit Mercedes ngjyrë e bardhë me targa të regjistrimit 631-KS-325 tani të ndjerit V. B. janë vërejtur njollat e gjakut dhe dy shufra metalike njëra në formë të rrumbullakët e tjetra në formë katrore dhe skica e përgjithshme e vendit të ngjarjes e dt.28.04.2015 dhe fotot e realizuar në vendin e ngjarjes, foto e frenimit të kamionit foto ku shihen njollat e gjakut në asfalte, foto e shpikave të metalit që janë përdorur në rast, fotot e shpikës së metalit në formë të rrumbullakët në gjatësi

prej 59 cm dhe në formë katrore 54 cm, foto e kamionit i cili ka qenë i involvuar në rast, foto e kamionit dhe njollave të gjakut në kamion, fotot e të dëmtuarit dhe lëndimeve të pësuar, në trup në kokë dhe në duar fotot e lëndimit të pësuar nga i pandehuri Rr. në duar, foto e lëndimit të pësuar nga tani i ndjeri V. B. pas trajtimit mjekësor, si dhe skica e vendit të ngjarjes.

- Raporti mjekësor i lëshuar nga Qendra Klinike Universitare në emër të dëmtuarit B. G. i datës 27.04.2015.

- Raporti mjekësor në emër të të ndjerit V. B. lëshuar nga QKUK me dt. 27.04.2015.

- Akt ekspertimi mjeko-ligjor në emër të dëmtuarit B. G. i dt. 25.10.2018, si dhe akt ekspertimi i datës 18.01.2019 ku është konstatuar se i dëmtuari B. G. ka pësuar dëmtime të rënda trupore

- Certifikata e vdekjes në emër të Valon Bregaj të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Vushtri.

- Vështrohet foto dokumentacioni përkatësisht 28 foto të cilat përfshirjen, foto 1 pamjen e përgjithshme të vendit të ngjarjes, foto 2 pamje e vendit të ngjarjes ku kishte frenuar kamioni, foto 3 dhe 4, 5 foto ku shihet në asfalt njolla ngjyrë gjaku, foto 6 vendi ku gjenden dy shipka metali ku ishin përdorur ne rast, foto 7 dhe 8 ku shihen dy shipka të metalit nga afër, foto 9 dhe 10 ku shihen njolla gjaku në asfalt, foto 11 ku shihen dy shipka me gjatësi 54 cm dhe 59 cm, foto 12 ku shihet shipka e metalit me gjatësi 59 cm në formë katrorë e cila ishte përdorur ne këtë rast, foto 13 ku nga afërsia shihet shipka e metalit me gjatësi 54 cm në formë kaltërorë e cila ishte përdorur në këtë rast, foto nr 14 shihet parkingu ku ishte parkuar kamioni i involvuar, foto nr 15 ku shihet kamioni ne parking dhe dera e hapur, foto nr 16 ku shihen njollat e gjakut në kamion, foto nr 17 dhe 18 ku shihen lëndimet në trup të të dëmtuarit B. G. foto nr 19 dhe 20 ku shihen lëndimet ne trup koke dhe duar të dëmtuarit, foto nr 21 dhe 22 lëndimet ne duar të të dëmtuarit , foto 23 dhe 24 personi i lënduar Rr.S. foto 25, 26, 27 dhe 28 shihet personi i lënduar ne koke Y. B.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet

Faktet jokontestuese

- Është fakt jo kontestues se i dëmtuari B.G. ka pësuar lëndime të rënda trupore me datë 27.04.2015 rreth orës 14:14 minuta në fshatin Stanoc i komunës së Vushtrisë;

- Është fakt jo kontestues së në vendin e ngjarjes në ditën kritike ka qenë i pandehuri Rrahim Sopjani, i pandehuri Y. B. i ndjeri V. B. i dëmtuari B. G. dhe bashkëshortja e të dëmtuarit A.P.-G.

- Është fakt jo kontestues se kamioni Mercedes ngjyrë e bardhë me targa të regjistrimit 631-KS-325, ka qenë i tani të ndjerit V. B.

- Është fakt jo kontestues se pronar i automjetit A.A6 ka qenë i dëmtuari B. G.

- Është fakt jo kontestues se në vendin e ngjarjes janë gjendur shipka e metalit me gjatësi 59 cm në formë kaltërore e cila ishte përdorur ne këtë rast, si dhe shipka e metalit me gjatësi 54 në formë të rrumbullakët.

Këto fakte nuk janë kontestuar nga palët. Përveç kësaj këto fakte vërtetohet edhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor që janë pjesë e kësaj lënde penale.

Faktet kontestuese

- Është fakt kontestues se të pandehurit Rr. S. dhe i pandehuri Y.B. i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarit B. G.

Ky fakte është kontestuar nga ana e të pandehurve dhe mbrojtëses së të pandehurit të dytë, në fjalën hyrëse, gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor, si dhe në fjalën përfundimtare.

Vlerësimi i provave nga gjykata

Gjykata pas prezantimit të provave, plotësisht dhe përtej dyshimit të bazuar, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dsipozitiv të aktgjykimit. Këtë gjendje faktike, gjykata e vërtetoi në bazë të:

- Dëgjimit të të dëmtuarit B. G. në cilësinë e dëshmitarit, i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 02.12.2020, me të cilën vërtetohet se gjate kësaj dite me dt 27.04.2015 ai ka qenë duke lëvizur me makinën e tij “A. A6” në fshatin S. në magjistralen Prishtinë-Vushtrri së bashku me të ka qene edhe gruaja e tij A. veturën e ka ndalur kur një kamion i cili ishte ndalur në rrugë. Vozitësi i kamionit me një shufër të metalit i është ofruar te dritarja anësore e veturës në pjesën e shoferit dhe fillimisht ka filluar me shajtë dhe me fyer. Më pas i njëjti person i shoqëruar edhe me persona tjerë që kanë pasur në dorë shufra metali i janë afruar veturës së tij dhe më pas ka vendosur me dal nga vetura së bashku me bashkës ortën A. me qëllim që të largohen nga aty dhe personi në fjalë e ka kapur për këmishe afër fyti e ka ngritur dorën me goditur me shufrën e metalit dhe më pas kanë ardhur edhe personat tjerë dhe më pas i dëmtuari së bashku me bashkëshorten kanë filluar të vetëmbrohen, personat të cilët e kanë sulmuar nuk i ka njohur më parë deri sa ka ardhur autobusi i policisë nga Vushtrria në drejtim të Prishtinës dhe policët kanë ndërhyrë për me i ndarë. Për të pandehurit ka deklaruar se i njuh dhe i janë kujtuar në gjykatë por edhe në polici, i pandehur i parë Rr. S.i kujtohet mirë që e ka sulmuar ditën kritike po ashtu i pandehuri i dytë Y. B. e ka sulmuar ditën kritike, i pandehuri i parë e ka goditur me shufër metalike ndërsa i pandehuri i dytë me shqelma në fytyrë, dhe nga këto goditje ka pësuar dëmtim të rëndë trupor dhe më pas ka ardhur ambulanca.

Gjykata i vlerësoi dhe nga deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit është bindëse dhe reale dhe në pajtim edhe me provat materiale, përfshirë:

- Raporti policor i dt. 27.04.2015 me të cilin raport vërtetohet, se ka ndodhur një rrahje mes disa personave V. B. B.G. Rr. S. A. P.-G. dhe Y. B. ku Policia e Kosoves gjatë shikimit të vendit të ngjarjes kanë gjetur një gyp metali dorëz e Vinçit të automjeteve i gjatësisë 54 cm dhe një gyp metalik katror 2x2 i gjatësisë 59 cm.

- Raporti i oficerit i dt. 27.04.2015, me të cilin raport vërtetohet se si ka ndodhur ngjarja ne ditën kritike, mjetet që janë përdorur, trajtimi i të dëmtuarit, si dhe njoftimi se në vendin e ngjarjes ka dalur njësitë i hetuesisë dhe forenzikes dhe mjetet që janë përdorur në këtë rrahje janë konfiskuar.

- Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes të datës 27.04.2015, me të cilin raport vërtetohet se ku ka ndodhur ngjarja dhe atë, në fshatin S. në rrugën Vushtrri – Prishtinë, në rrugë në anën e djathtë janë vërejtur shenjat e frenimit të kamionit Mercedes ngjyrë e bardhë me targa të regjistrimit 631-KS-325 tani të ndjerit V. B. se si janë vërejtur njollat e gjakut dhe dy shufra metalike njëra në formë të rrumbullakët e tjetra në formë katrore dhe skica e përgjithshme e vendit të ngjarjes

e dt.28.04.2015 dhe fotot e realizuar në vendin e ngjarjes, foto e frenimit të kamionit foto ku shihen njollat e gjakut në asfalte, foto e shpikave të metalit që janë përdorur në rast, fotot e shpikës së metalit në formë të rumbullaktë në gjatësi prej 59 cm dhe në formë katrore 54 cm, foto e kamionit i cili ka qenë i involvuar në rast, foto e kamionit dhe njollave të gjakut në kamion, fotot e të dëmtuarit dhe lëndimeve të pësuar, në trup në kokë dhe në duar fotot e lëndimit të pësuar nga i pandehuri Rr. në duar, foto e lëndimit të pësuar nga tani i ndjeri V. B.pas trajtimit mjekësor, si dhe skica e vendit të ngjarjes.

- Raporti mjekësor i lëshuar nga Qendra Klinike Universitare në emër të dëmtuarit B. G. i datës 27.04.2015.

- Raporti mjekësor në emër të të ndjerit V. B.lëshuar nga QKUK me dt. 27.04.2015.

- Akt ekspertimi mjeko-ligjor në emër të dëmtuarit B. G.i dt. 25.10.2018, si dhe akt ekspertimi i datës 18.01.2019 me të cilin vërtetohet se i dëmtuari B. G. ka pësuar dëmtime të rënda trupore

- Certifikata e vdekjes në emër të V. B. të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Vushtrri.

- Vështrohet foto dokumentacioni përkatësisht 28 foto të cilat vërtetojnë, pamjen e përgjithshme të vendit të ngjarjes, pamjen e vendit të ngjarjes ku kishte frenuar kamioni, njolla ngjyrë gjaku të gjetura në asfalt, vendi ku gjenden dy shpika metali ku ishin përdorur ne rast me gjatësi 54 cm dhe 59 cm, njëra bë formë kaltërore e cila ishte përdorur ne këtë rast, foto 13 ku nga afërsia shihet shpika e metalit me gjatësi 54 cm në formë kaltërore dhe tjetra në formë të rumbullakët, parkingu ku ishte parkuar kamioni i involvuar, kamioni ne parking dhe dera e hapur, njollat e gjakut në kamion, lëndimet në trup të të dëmtuarit ku shihen lëndimet ne trup koke dhe duar të dëmtuarit, lëndimet e pësuar nga i pandehuri i parë Rr. S. sh personi i lënduar ne koke Y.B. tani i ndjerë.

Kjo gjykatë, konsideron se përtej çdo dyshimi të bazuar, është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se në veprimet e të pandehurve, manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale, Lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par 1 pika 1.3 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që të pandehurit i kishin shkaktuar lëndime të rënda të dëmtuarit me përdorimin e forcës.

Për gjykatën deklarata e të pandehurve në fjalën hyrëse, me rastin e marrjes në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ishin, kontestuese, jo të plota, jo bindëse dhe kishin për qëllim shmangien nga përgjegjësia penale dhe të njëjave gjykata nuk ja fali besimin, ndërsa sa i përket deklaratës së dëshmitarit Y. B. i njëjti ka deklaruar se me datë 27.04.2015 rreth orës 14:14 ka qenë në vendin e ngjarjes ku ka ndodhur rrahja larg 100 metra me një klient të tij dhe më pas kanë ndërhyrë policia dhe nuk ka lënë askënd të ofrohet, deklarata e tij ka qenë subjektive pasi që i njëjti e ka të afërm të pandehurin e dytë dhe kundërthënëse dhe gjykata për këto arsye nuk ia fali besimin.

II. Ndaj të pandehurës A. P.G. gjykata me datë 24.08.2020 ka marrë aktvendim P.nr.129/2020 për aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimi me datë 11.08.2020 sa i përket dispozitivit II të aktakuzës, pasi që palët fillimisht kanë propozuar dhe më pas janë pajtuar që lënda sa i përket dispozitiv II të aktakuzë të zgjidhet në procedurë të ndërmjetësimit, dhe gjykata në pajtim me nenin 15 të Ligjit për Ndërmjetësim ka aprovuar marrëveshjen, pasi që e njëjta është lidhur në pajtim me procedurën ligjore të përcaktuar me këtë ligj.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 dhe 74 të KPRK-ës. Si rrethana rënduese sa i përket të pandehurit të parë gjykata ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur – në rastin konkret dëmin e shkaktuar ndaj palës së dëmtuar, mënyrën e kryerjes së veprës penale, gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë vepër e kishte kryer me dashje, ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar, rrethanat personale pasi që i pandehuri është i martuar dhe jeton vetëm me bashkëshorten, i njëjti është punëtor krahu dhe i pa shkolluar, nuk e ka përsëritur veprën penale, dhe se më parë nuk ka ra ndesh me ligjin. Si rrethana rënduese sa i përket të pandehurit të dytë gjykata ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur – në rastin konkret dëmin e shkaktuar ndaj palës së dëmtuar, mënyrën e kryerjes së veprës penale, gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë vepër e kishte kryer me dashje, ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar, rrethanat personale pasi që i pandehuri është i martuar dhe prind i tre fëmijëve, i njëjti nuk e ka përsëritur veprën penale, dhe se më parë nuk ka ra ndesh me ligjin..

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurve është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par. 1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPPK-së.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike

Lidhur me kërkesën pasurore juridike, Gjukata ka vendosur në kuptim të nenit 461 të KPPK-së, pasi që i dëmtuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka hequr dorë nga e drejta e realizimit të kërkesës pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale.

Andaj gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.129/2020, datë: 24.02.2021

Procesmbajtësja

GJYQTARI

Bahrije Smakolli

Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.